

PYETJE: «A KA JETË PAS VDEKJES?»

PËRGJIGJE: Ne të gjithë e dimë se një ditë do të vdesim. Pyetja është kjo: «Çfarë vjen pas vdekjes?» Jobi bëri të njëjtën pyetje: «Në qoftë se njeriu vdes, a mund të kthehet përsëri në jetë? . . .» (Jobi 14:14). Një burrë 80 vjeç po i thoshte një mikut tim se po e priste ditën e vdekjes. Miku im e pyeti: «A e di vendin ku do të shkosh?» «Po», iu përgjigj ai: «Unë ose do të përfundojë gjashtë pashë nën dhe; ose do të përfundoj në krematorium.» A është e vërtetë çka thotë ai? A është kjo gjithçka që ndodh pas vdekjes?

Njerëzit gjithmonë kanë shpresuar që të kenë jetë pas vdekjes. Robert Ingersoll, një aktivist i shquar në luftën kundër fesë, që filloi në shekullin e nëntëmbëdhjetë, shpresonte që jeta të vazhdonte përtej vdekjes. Në fjalimin që mbajti mbi varrin e vëllait të tij ai tha:

. . . Në natën e vdekjes shpresa rishfaqet dhe dashuria për jetën ripërtërihet. Indjeri, në momentin e vdekjes, duke ngatërruar ardhjen e vdekjes me atë të shërimit, pëshpëriti: «Unë ndihem më mirë tani.» Le të besojmë se, pavarësisht nga dyshimet dhe dogmat, pavarësisht nga lotët dhe frika, këto fjalë të çmuara janë të vërteta për të gjithë të vdekurit e panumërt.

Ingersoll donte të besonte se parajsa, vendi ku shpirti i besimtarëve të Perëndisë shkon pas vdekjes, ekzistonte. Ne të gjithë duam të besojmë në jetën pas vdekjes. Por, a mund të besojmë në të, në jetën pas vdekjes?

Bibla i përgjigjet kësaj pyetjeje me një siguri të pagabueshme. Por kjo nuk i vë kapakun çdo gjëje. *Çfarë ndodh tjetër, sipas Biblës, me njeriun pas vdekjes?*

Për të dhënë një përgjigje sa më të thjeshtë, le të tregojmë historinë e jetës, vdekjes dhe të pasvdekjes të Sokol Petritit¹. Mbani në mendje se Sokol Petriti është një person imagjinar, që përfaqëson secilin

prej nesh. Ai mund jem unë, mund të jesh ti apo çdo person tjetër në botë.

SOKOL PETRITI GJATË JETËS NË TOKË

Shkrimtari i Psalmeve pyet: «Sa i vogël është njeriu! Megjithatë ti kujdesesh për të» (Psalmeve 8:4). Çfarë është Sokol Petriti gjatë jetës së tij në tokë?

Ai ka një shpirt, ose e thënë ndryshe, ai është një shpirt. Në fakt, kjo është gjëja më e rëndësishme për Sokol Petritin apo për çdo qenie njerëzore. Në fund të fundit, njeriu u krijua në ngjashmëri me Perëndinë dhe Perëndia është shpirt (Gjoni 4:24). Si rrjedhim, njeriu është *më shumë se një trup*, mbi të gjitha ai është një qenie shpirtërore. Apostulli Pal duke folur për njeriun thotë se ai përbëhet nga «njeriu i brendshëm» dhe nga «njeriu i jashtëm» (2 Korintasve 4:16; Efesianëve 12:7).

Ai gjithashtu ka një trup fizik (të cilin mund ta prekim apo ta shikojmë). Pali shkroi: «Po ju bëj thirrje, nëpërmjet dhembshurisë së Perëndisë, ta paraqisni trupin tuaj si fli të gjallë, të shenjtëruar . . .» (Romakëve 12:1). Ai bën dallimin midis «juve» dhe «trupave tuaj». Thelbi i ekzistencës së kristianëve në Romë, shkruan Pali, nuk ishin trupat e tyre. Ata ishin më shumë se trupa njerëzore dhe, për më tepër, *ata* duhet t'i kontrollonin trupat e tyre. Pali nuk mund ta barazonte ekzistencën e tyre thjesht me trupat e tyre.

Ai gjithashtu ka një personalitet. Ne po e përdorim fjalën «personalitet» për të përshkruar cilësitë mendore, emocionale dhe të temperamentit të një njeriu, cilësi që e bëjnë çdo njeri të dallueshëm nga njerëzit e tjerë. Sokol Petriti mund të jetë miqësor apo mund të mos jetë i tillë, mund të jetë i sjellshëm apo i pasjellshëm, i përrulur apo arrogant. Gjithë veprimet e tij në jetë, zakonet e tij dhe

karakteristikat personale të tij e bëjnë atë të dallueshëm nga të tjerët.

Sokol Petriti ka përgjegjësinë t'i shërbejë Perëndisë dhe njerëzve përreth tij gjatë gjithë jetës së tij. A e bën ai këtë? Vetëm ai dhe Perëndia e dinë përgjigjen e saktë të kësaj pyetjeje.

SOKOL PETRITI NË MOMENTIN E VDEKJES

Çfarë ndodh me Sokol Petritin pas vdekjes së tij? Vdekja është një ndarje. Jakobit 2:26 thotë: «Sepse, sikurse trupi pa frymë është i vdekur, ashtu edhe besimi, pa vepra, është i vdekur.» Trupi dhe fryma ndahen nga njëri-tjetri, kur fryma largohet prej trupit dhe, si pasojë e kësaj, vjen vdekja. Vdekja është përshkruar si ndryshimi i rrobave, heqja e «çadrës tokësore që është banesa jonë» dhe veshja e «banesës sonë qiellore» (2 Korintasve 5:1, 2, 4, 8).

Në qoftë se humbni një dorë (si pasojë e një aksidenti apo sëmundjeje), ju prapë jeni i njëjti person. Njerëzit e tjerë ju thërrasin me të njëjtin emër dhe karakteristikat tuaja janë të njëjta. Madje edhe nëse humbni të dy krahët dhe këmbët, ju prapë jeni po ai person që keni qenë. Atëherë, përfytyrojeni vdekjen jo si ndarje nga krahët apo këmbët tuaja, por si një ndarje nga i gjithë trupi juaj. Ashtu sikurse ju mbeteni i njëjti person pasi keni humbur një dorë, në të njëjtën mënyrë personi juaj mbetet po ai dhe nuk vdes kur trupi juaj vdes. Kështu, kur Sokol Petriti vdes, pavarësisht se e «zhvesh» trupin e tij, ai akoma vazhdon të ekzistojë.

SOKOL PETRITI NË FERR

Çfarë ndodh menjëherë pas vdekjes të Sokol Petritit? Në tregimin e pasanikut dhe lypësit Llazar të treguar nga Jezusi, pasaniku «jetonte në luks çdo ditë», ndërsa lypësi Llazar ishte i uritur, i sëmurë dhe i varfër. Te Luka 16:22–31 thuhet:

«Por ndodhi që lypësi vdiq dhe engjëjt e çuan në gji të Abrahamit; vdiq edhe pasaniku dhe e varrosën. Dhe, duke pasur mundime në ferr, i çoi sytë dhe pa nga larg Abrahamin dhe Llazarin në gjinjtë e tij. Atëherë ai bërtiti dhe tha: “O atë Abraham, ki mëshirë për mua, dhe dërgoje Llazarin të lagë majën e gishtit të vet në ujë që të më freskojë gjuhën, sepse po vuaj tmerrësisht në këtë flakë.” Por Abrahami thoshte: “O bir, kujto se ti i ke marrë të mirat e tua gjatë jetës sate, kurse Llazarit të këqijat; tashti, përkundrazi, ai po përdëllehet dhe ti vuan. Dhe, veç të gjithave, midis nesh dhe jush është një humnerë e madhe,

kështu që ata që do të donin të kalonin që këtej te ju nuk mundin; po ashtu askush nuk mund të kalojë që andej te ne.” Por ai i tha: “Atëherë, o atë, të lutem ta dërgosh atë te shtëpia e tim eti, sepse unë kam pesë vëllezër e le t'i paralajmëroj rreptësisht që të mos vijnë edhe ata në këtë vend mundimesh.” Abrahami u përgjigj: “Kanë Moisiun dhe profetët, le t'i dëgjojnë ata.” Ai tha: “Jo, o atë Abraham, por nëse dikush nga të vdekurit do të shkojë te ata, do të pendohen.” Atëherë ai i tha: “Nëse ata nuk e dëgjojnë Moisiun dhe profetët, nuk do të binden edhe në se dikush ringjallet prej të vdekurish.”»

Nga kjo pjesë ne mund të mësojmë, e para, se në çfarë kthehet një njeri pas vdekjes.

Ai është akoma një shpirt. Llazari dhe pasaniku i lanë trupat e tyre mbrapa, por ata akoma ekzistonin në formë shpirtërore.

Pas vdekjes, njeriu ka një trup shpirtëror. Pali thotë se kur të vdesim ne nuk do të gjendemi të paveshur, sepse ne do të veshim banesën qiellore (2 Korintasve 5:2–4). Ai thotë të njëjtën gjë kur i përgjigjet pyetjes: «Si ringjallet të vdekurit, edhe me ç'trup do të vijnë?» (1 Korintasve 15:35). Ai thotë: «Mbillet trup natyror dhe ringjallet trup frymëror . . . » (1 Korintasve 15:44). Pse është e nevojshme për ne të veshim trupa shpirtërorë? Sepse «mishi dhe gjaku nuk mund të trashëgojnë mbretërinë e Perëndisë . . . » (1 Korintasve 15:50). Për të njëjtin qëllim, ata që janë gjallë kur Krishti të kthehet «do të shndërrohen të gjithë» (1 Korintasve 15:51), sepse «ky trup që prishet duhet të veshë mosprishjen dhe ky i vdekshëm të veshë pavdekësinë» (1 Korintasve 15:53). Si rrjedhim, çdo njeri që ka vdekur do të ketë një trup shpirtëror.

Njeriu prapë ka *personalitetin* e tij të mëparshëm. Pasaniku dhe Llazari e ruajtën personalitetin e tyre. Pas vdekjes, njeriu nuk është një masë pa formë apo një shpirt i padallueshëm. Njeriu ruan kujtesën, ndërgjegjen dhe aftësinë për të menduar, për të arsyetuar, për të ndjerë dhe ai mund të provojë dhembjen e torturës. Ne nuk vdesim dhe pastaj kthehemi në jetë tërësisht të ndryshuar. Pas vdekjes ne prapë do të jemi të njëjtët persona që kemi qenë para saj.

Nga ky tregim, ne mësojmë vendin ku njeriu shkon pas vdekjes. Ky tregim nuk shpjegon se çfarë ndodhi pas Ditës së Gjykimit, sepse jeta akoma po vazhdonte në tokë, pasaniku kishte pesë vëllezër të cilët akoma jetonin. Por pas gjykimit nuk do të ketë më ndonjë njeri të gjallë në tokë, meqënëse toka do të shpërbëhet me ardhjen e Krishtit (2 Pjetrit 3:10).

Çfarë mësojmë rreth vendit ku njerëzit do të shkojnë pas vdekjes?

Disa, si Llazari, do të shkojnë në vendin e paqes. Ky vend quhet Parajsë dhe, sipas asaj që Jezusi i tha hajdutit që po kryqëzohej bashkë me të, ky është vendi ku Jezusi shkoi pas vdekjes (Luka 23:43). Por Parajsa duhet të jetë pjesë e Hadesit², sepse Bibla na mëson se Jezusi gjithashtu shkoi në Hades. Pjetri tha se Davidi «duke parashikuar këtë, foli për ringjalljen e Krishtit, duke thënë se shpirti i tij nuk do të lihej në Hades dhe se mishi i tij nuk do të shihte kalbjen» (Veprat 2:31).

Të tjerët, si pasaniku, shkuan në vendin e ndëshkimit. Pasaniku gjithashtu ishte në Hades: «. . . vdiq edhe pasaniku . . . duke pasur mundime në Hades, i çoi sytë dhe pa nga larg Abrahamin . . . » (Luka 16:22, 23).

Si mundet që dy vende, vendi i paqes dhe ai i ndëshkimit, të jenë në Hades? Hades është vendi ku gjithë të vdekurit shkojnë, pavarësisht nëse ata janë të drejtë apo të padrejtë. Hades ka dy pjesë, vendin e paqes dhe atë të ndëshkimit. Me siguri, Pjetri te 2 Pjetrit 2:4 po fliste për vendin e ndëshkimit në Hades kur ai përdori fjalën greke *tartarus* (apo *tartar*, sipas Biblës në shqip). Ky është vendi ku njerëzit e këqinj të të gjitha kohërave presin ndëshkimin e tyre.

Në Hades, ndodhet një humnerë e madhe midis atyre që janë në Parajsë dhe atyre që janë në Tartarus. Pasaniku kërkoi që Llazari të shkojë dhe «të lagë majën e gishtit të vet në ujë që të më freskojë gjuhën» (Luka 16:24). Abrahami iu përgjigj: «Midis nesh dhe jush është një humnerë e madhe, kështu që ata që do të donin të kalonin që këtej te ju nuk mundin; po ashtu askush nuk mund të kalojë që andej te ne» (Luka 16:26). Humnera nuk mund të kalohet. Një njeri që është në vendin e ndëshkimit nuk mund të kalojë në anën tjetër.

Ku shkon Sokol Petriti menjëherë pas vdekjes? Përgjigjja është se vendi ku do të shkojë varet nga jeta që ai ka jetuar në tokë, ashtu si edhe vendi ku pasaniku dhe Llazari shkuan u përcaktua nga lloji i jetës së tyre në tokë.

Vëreni, se tregimi i pasanikut dhe Llazarit vërteton se të paturit e një jete të rehatshme në këtë tokë nuk garanton një jetë të rehatshme në botën tjetër. Ju ndoshta jetoni përditë një jetë luksoze, megjithatë, në qoftë se ju nuk i bindeni Perëndisë, menjëherë pas vdekjes mund të përfundoni si

pasaniku, në vendin e ndëshkimit të tmerrshëm!

SOKOL PETRITI KUR KRISHTI TË VIJË PËR HERË TË DYTË

E katërta, le të mendojmë për Sokol Petritin gjatë ardhjes së dytë të Krishtit. Krishti do të vijë përsëri! Një engjëll, pikërisht para ngritjes së Jezusit në qiell, tha: «. . . Ky Jezus, që u është marrë në qiell nga mesi juaj, do të kthehet në të njëjtën mënyrë, me të cilën e keni parë të shkojë në qiell» (Veprat 1:11). Sipas Testamentit të Ri, asgjë nuk mund ta parandalojë ardhjen e Tij.

Çfarë do të ndodhë kur Krishti do të kthehet?

Kur Krishti do të kthehet përsëri, Sokol Petriti dhe gjithë të vdekurit do të ngrihen nga vdekja. Jezusi tha: «. . . sepse po vjen ora kur të gjithë ata që janë në varre do ta dëgjojnë zërin e Tij dhe do të dalin prej tyre, ata që kanë bërë të mira, në ringjalljen e jetës dhe ata që kanë bërë të liga, në ringjalljen e dënimit» (Gjoni 5:28, 29). I drejti dhe i padrejti do të grihen nga vdekja në të njëjtën kohë.

Kur Krishti do të vijë përsëri, ata që janë gjallë do të shndërrohen: «Ja, unë po ju them një të fshehtë: të gjithë nuk do të vdesim, por të gjithë do të shndërrohemi, . . . në tingullin e burisë së fundit, . . . të vdekurit do të ringjallen të paprishshëm dhe ne do të shndërrohemi» (1 Korintasve 15:51–53). Pas ringjalljes, Sokol Petriti do të ketë përsëri një trup, por ai do të jetë një trup i një lloji tjetër. Ky trup, përveç gjërave të tjera, do të jetë i paprishshëm dhe shpirtëror (1 Korintasve 15:42–44).

Bota do të shkatërrohet gjatë ardhjes së dytë të Krishtit.

Dhe dita e Zotit do të vijë si një vjedhës natën, atë ditë qiejt do të shkojnë me krismë, elementët do të shkrihen nga të nxehtit dhe veprat dhe toka që janë në të do të digjen krejt (2 Pjetër 3:10).

Çdo gjë në botë, vetë bota, universi që përmban botën dhe gjithë ato gjëra materiale, të cilave njerëzit u dedikojnë jetën e tyre, do të digjen krejt me ardhjen e Krishtit! Çfarë lloji njerëzish do të bëhemi ne atëherë (2 Pjetër 3:11)? Natyrisht, gjërat materiale nuk do të kenë më vlerë për jetët tona!

SOKOL PETRITI NË DITËN E GJYKIMIT

E pesta, mendohuni për Sokol Petritin gjatë ditës së gjykimit.

Kur të kthehet Krishti, diçka tjetër do të ndodhë.

Në atë kohë gjithë njerëzit do të gjykoen:

«Dhe kur të vijë Biri i njeriut në lavdinë e tij, bashkë me të gjithë engjëjt e shenjtë, atëherë do të ulet mbi fronin e lavdisë së vet. Dhe të gjitha kombet do të mblidhen para tij, dhe ai do ta ndajë njërin nga tjetri ashtu si i ndau bariu delet nga cjepët» (Mateu 25:31, 32).

Ka pyetje të tjera për gjykimin që kërkojnë përgjigje:

Kush do të gjykohet? Çdo njeri! Gjoni tha: «. . . dhe ata u gjykuan secili sipas veprave të tyre» (Zbulesa 20:13; Romakëve 14:10–12). Pavarësisht nëse na pëlqen apo jo, nëse jemi gati apo jo, ne të gjithë do të gjykohemi! Secili prej nesh do të gjykohet një ditë (Hebrenjve 9:27).

Cili do të jetë gjykatësi? Perëndia «ka caktuar një ditë në të cilën do të gjykojë me drejtësi botën me anë të atij njeriu të cilin Ai e ka caktuar, dhe për këtë u ka dhënë të gjithëve një provë të sigurtë, duke e ringjallur prej të vdekurit» (Veprat 17:31).

Mbi ç' baza do të bëhet gjykimi? Shpëtimi apo ndëshkimi ynë varet nga fakti nëse jemi të larë në gjakun e Krishtit apo jo (Zbulesa 7:14). Më tej, Testamenti e Ri flet për dy lloj gjykatësish. E para, ne do të gjykohemi nga fjala e Krishtit. Jezusi tha: «. . . fjala që fola do ta gjykojë atë në ditën e fundit» (Gjoni 14:28). E dyta, ne do të gjykohemi nga veprat tona. «. . . secili merr shpagimin e gjërave që ka bërë me anë të trupit, në bazë të asaj që ka bërë, qoftë në të mirën apo në të keqen» (2 Korintasve 5:10; Zbulesa 20:12, 13; Predikuesi 12:14). Si mund të harmonizohen këto dy mënyra gjykimi? Gjykimi ynë do të bëhet nga fjalët e Krishtit sipas veprave tona. Gjykimi ynë do të bëhet mbi bazën e faktit se sa shumë ne, me veprimet tona, u jemi bindur urdhërimeve të Krishtit, të cilat gjenden në Fjalën e Tij.

Atëherë, cili do të jetë vendimi për Sokol Petritin në ditën e gjykimit? Në fakt, ky vendim po shkruhet çdo ditë nga vetë Sokol Petriti. Meqënëse gjykimi i Sokol Petritit do të varet nga bindja e tij ndaj vullnetit të Perëndisë, pra nga bindja apo mosbindja ndaj Perëndisë, është ai vetë që vendos nëse do të shpëtohet apo jo në ditën e gjykimit. Kështu vendimi varet nga vetë ne. Bindja apo mosbindja e përditshme ndaj mësimëve të Krishtit, ja çfarë do të përcaktojë

nëse do të zgjedhim shpëtimin apo dënimin e përjetshëm.

SOKOL PETRITI NË PËRJETËSI

E gjashta, mendohuni për Sokol Petritin në përjetësi.

Çfarë gjëra mund t'i ndodhin Sokol Petritit? Mateu 25:46 thotë: «Dhe ata do të shkojnë në mundim të përjetshëm dhe të drejtët në jetën e përjetshme.»

Ekzistojnë vetëm dy mundësi për Sokol Petritin dhe gjithë ne të tjerët: ndëshkimi i përjetshëm në ferr apo jeta e përjetshme në qiell. Vëreni se te Mateu 25:46 të dy mundësitë janë të njëjta. Ne duhet të arrijmë në përfundimin se njëra nga mundësitë është po aq e vërtetë dhe zgjat po aq shumë në kohë, sa edhe tjetra. Në qoftë se ka një parajsë dhe nëse parajsa zgjat përjetësisht, atëherë ka edhe një ferr dhe ai zgjat, ashtu si parajsa, përjetësisht.

A është e vërtetë parajsa? Në 1969, një gazetë në Australi në faqen e parë kishte kryeartikullin me titullin: «A Është Vërtetë Parajsa?» Kjo gazetë jepte rezultatet e një «sondazhi të shpejtë në tokë» për pikëpamjet e një numri njerëzish për parajsën.

. . . Një humanist³ tha: «Ne e mohojmë idenë e ekzistencës së qiellit dhe ferrit. Ferrin e konsiderojmë si një koncept djallëzor.» Një rabi (priefi hebre) tha se qielli nuk është veçse një ide shpirtërore. Një skulptor tha se ai ishte i lumtur se një ditë do të lundronte në zbrazëtirën e harresës, por ai shpresonte që shumë shpejt të ndiqte ndonjë ide që ishte më e qëndrueshme . . . Dhe presidenti i Qendrës Amerikane për Studimin e Objekteve Fluturuese të Pidentifikuar tha se qielli dhe ferri janë krijuar nga imagjinata e njeriut dhe ka mundësi që hapësira të jetë vend strehimi për një planet tjetër ku jetojnë njerëz me një qytetërim më të lartë se ky i yni.

Pavarësisht nga ajo që njerëzit mendojnë, Bibla na mëson se qielli ekziston dhe kjo është shumë e rëndësishme për ne.

A ekziston ferri në të vërtetë? Disa e kundërshtojnë pikëpamjen se ferri është vendi i ndëshkimit të përjetshëm. Ata besojnë se ferri zgjat vetëm për një moment dhe jo përjetësisht. Sipas tyre, njerëzit e këqinj thjesht shkatërrohen, ata pushojnë së ekzistuari. Por Bibla nuk na mëson se të këqinjët do të ndalojnë së ekzistuari. Por ajo na

mëson se ata do të vuajnë përjetësisht. Zbulesa 14:11 thotë: «Dhe tymi i mundimeve të tyre ngjitet në shekuj të shekujve dhe ata nuk do të kenë prehje ditë e natë . . .»

«Kjo është shumë e pamëshirshme», mund të kundërshtojë dikush. «As njerëzit nuk i torturojnë njerëzit e tjerë në këtë lloj mënyre. Natyrisht Perëndia nuk do t'i torturojë ata që e mohojnë Atë dhe Fjalën e Tij.» Mendoni përsëri: Pse Perëndia nuk duhet të ndëshkojë njerëzit e këqinj? Ata kanë mëkatuar kundër Perëndisë së mirë. Ata i kthyen krahët sakrificës që Perëndia ka bërë për ta. Jeta e tyre ka qenë një rebelim ndaj ndaj Perëndisë së plotfuqishëm. Ata kanë hedhur poshtë me mos-përfillje çdo mundësi për t'u shpëtuar. Ata kanë bërë një mëkat të përjetshëm, një mëkat kundër Perëndisë së përjetshëm dhe kështu, meritojnë ndëshkimin e përjetshëm.

Me çfarë ngjason ferri? Testamenti i Ri e përshkruan ferrin (midis gjërave të tjera) si një liqen të zjarrtë (Zbulesa 20:15), si një furrë të zjarrtë dhe vend vajtimi (Mateu 13:42), vend ndëshkimi (Luka 16:23), vend të errësirës së jashtme (Mateu 8:12), një vend ku njerëzit bërtasin për mëshirë (Luka 16:24), vend të ndëshkimit të përjetshëm (Mateu 25:46), vend të përgatitur për djallin dhe engjëjt e tij (Mateu 25:41), vend ku digjesh me zjarr dhe squfur (Zbulesa 21:8).

Ku do të jetë Sokol Petriti gjatë përjetësisë? Qartësisht, në qiell ose në ferr. Vendi ku do të përfundojë Sokol Petriti varet nga ai vetë. Nëse ai pranon shpëtimin përmes gjakut të Krishtit duke iu bindur ungjillit të Tij dhe, më pas, jeton duke u përpjekur të bëjë vullnetin e Perëndisë, ai mund të jetë i sigurt se do ta kalojë përjetësinë në qiell. Por, nëse ai jeton në mëkat dhe vetëm për vete, ai mund të jetë i sigurt se do të ndëshkohet dhe do ta kalojë përjetësinë në ferr.

KONKLUZIONI

Kjo pyetje mund të jetë një nga pyetjet më të rëndësishme të bëra ndonjëherë: *Ku mendon se do ta kalosh përjetësinë?* Vetëm dy mundësi ekzistojnë: qielli apo ferri. Nuk ka ndonjë mundësi të tretë. Dhe ne mund të themi për përjetësinë tuaj të njëjtën gjë që thamë për atë të Sokol Petritit: Gjithçka varet

nga ju. Ju vetë, në këto momente, nga mënyra se si po jetoni, po përcaktoni vendin se ku do kaloni përjetësinë.

Në qoftë se jeni shpëtuar me anë të gjakut të Krishtit duke iu bindur ungjillit dhe pastaj jetoni duke u përpjekur të bëni vullnetin e Tij, ju mund të siguroheni se do ta kaloni përjetësinë në paqe në praninë e Perëndisë. Por nëse jetoni në mëkat, ju duhet ta dini se do të ndëshkoheni dhe do ta kaloni përjetësinë në ferr. Ju përket juve të vendosni nëse doni të shkoni në parajsë apo në ferr!

Gjatë një ëndrre një natë, isha duke udhëtuar me një makinë në një rrugë të zbrazur në mes të një pylli, në mes të dimrit. Arrita në një kryqëzim, u ktheva nga e majta dhe vazhdova rrugën. Rruga sa po vinte ngushtohej dhe bëhej më e keqe derisa makina nuk mund të vazhdonte më. Unë ëndërrova se u ktheva mbrapa dhe më në fund arrita te kryqëzimi i mëparshëm. *Papritur, unë nuk e dija se ku isha apo ku po shkoja.* Unë u ndieva tërësisht i braktisur. Ajo ishte një ndjenjë e tmerrshme dhe një përvojë e frikshme, aq e frikshme sa më zgjoi nga gjumi dhe më bëri që ta mbaj mend ëndrrën.

Shumë njerëz janë kaq të preokupuar me *të tashmen*, sa ata nuk kanë kohë të mendojnë për *të ardhmen*. Ata mendojnë kaq shumë për *këtë jetë*, sa nuk kanë kohë të mendojnë për *jetën tjetër*. Ata përqëndrohen kaq shumë në *momentin*, sa nuk mendojnë për *përjetësinë*. *Ata me të vërtetë, në një farë kuptimi, nuk e dinë se ku janë apo se ku po shkojnë!*

Në qoftë se kjo është e vërtetë për ju, mendohuni me kujdes për pasojat e përjetshme të asaj që po bëni sot. Sigurohuni se po jetoni në mënyrë të tillë që e *dini* se po shkoni në parajsë!

SHËNIME

¹ Emri Sokol Petriti i referohet këtu një personi imagjinar.

² Kuptimi i kësaj fjale është «vend i padukshëm». Është vendi i qëndrimit ose banesa e nëndheshme e të vdekurve deri në kohën e gjyqit.

³ Përkrahës i i nje filozofie apo pikëpamjeje që vendos në qendër të botës njeriun, arritjet dhe interesat e tij, duke e mohuar plotësisht fenë apo njeriun shpirtëror. Humanizmi filloi si një lëvizje kulturore dhe intelektuale gjatë periudhës të Rilindjes Evropiane dhe shumë shpejt promovimi i njeriut dhe i aftësive të tij u shndërruan në qëllimin e kësaj filozofie. Sot kjo filozofi (mënyrë e shpjegimit të botës) ka një përhapje të gjerë.

Cili kompliment do t'ju pëlqente?

Ndërsa dy shokë po dilnin nga shërbesa e nderimit, njëri i tha tjetrit: «Mua më pëlqen ai *predikues.*» Tjetri iu përgjigj: «Mua më pëlqen ai lloj *predikimi.*»

Koha për të ndaluar

Dikush pyeti një njeri në kishë nëse folësi kishte mbaruar fjalimin. «Oh, po», iu përgjigj ai, «mbaroi para dhjetë minutash, por akoma s'ka pushuar së foluri!»

Autor: *Coy Roper*

Marrë nga studimi: *"Pyetje lidhur me besimin te Perëndia"*

© 2001, 2003 E VERTETA PER SOT

Të gjitha të drejtat të rezervuara